

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE**

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR VLERËSIMIN E GJENDJES DHE PËRMIRËSIMIN E
RRUGËVE TË FSHATRAVE NDËRKUFITARE QË LIDHIN
ZONAT KUFITARE SHQIPËRI-KOSOVË**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë, këtu e më poshtë të referuara si “palët”,

Në kuadër të revitalizimit të angazhimit për bashkëpunim të ngushtë institucional, ekonomik e kulturor mes Shqipërisë dhe Kosovës qeveritë e dy vendeve konfirmojnë vullnetin e tyre për jetësimin e një proces zhvillimi të qëndrueshëm në të dy vendet;

Duke konsideruar këtë angazhim të përbashkët të rëndësishëm në përmirësimin e cilësinë e jetës, reduktimit të pabarazive dhe varfërisë, veçanërisht të qytetarëve lokal të brezit kufitar Shqipëri-Kosovë, dhe në të njëjtën kohë që ndihmon në lëvizjen e lirë të punëtorëve, shërbimeve, mallrave sipas normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian;

Duke vlerësuar identitetin e fortë territorial të qytetarëve të brezit kufitar, identitet i formuar bazuar në histori dhe traditë të përbashkët shekullore që kushtëzon dinamika e zhvillimit lokal dhe rajonal, pavarësisht vështirësive dhe barrierave të formave të ndryshme;

Bazuar në situatën aktuale të shtrirjes jo uniforme të shërbimeve publike që krijon nga njëra anë e qytetarëve të marxhinalizuara dhe nga ana tjetër një presion të rritur zhvillimor në qytetarët tjerë;

Duke vlerësuar problemet zhvillimore që burojnë nga barrierat administrative dhe aksesit i ulët në shërbime e tregje për qytetarët lokal të brezit kufitar Shqipëri-Kosovë;

Duke vlerësuar potencialet e mëdha për zhvillim të përbashkët në zonën e brezit kufitar Shqipëri – Kosovë, të cilat paraqesin mundësi të përbashkëta për zhvillim ekonomik dhe social të ndërsjellët, të konsideruara deri më tani si mundësi të humbura;

Duke synuar të ofrojmë një instrument të dobishëm për qeveritë në nivel qendror, me qëllim maksimizimin e burimeve dhe mjeteve të përcaktuara për zhvillimin e qytetarëve në zonë për t'i dhënë shtysë veprimit të përbashkët.

Kanë rënë dakord sa vijon:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është përmirësimi i infrastrukturës rrugore të fshatrave që lidhin zonat kufitare të Shqipërisë-Kosovës, për të lehtësuar kalimet kufitare, sigurimin e lidhjeve për transport të shpejtë dhe pa probleme të mallrave, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, arritjen e lëvizshmërisë së qëndrueshme me efikasitet dhe cilësi të lartë të shërbimit të transportit në periudha afatgjatë.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente

angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e përcaktuara, si më poshtë vijojnë:

- 1.1. Vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore përmes një studimi të përbashkët.
- 1.2. Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugëve të fshatrave ndërkufitare që lidhin zonat kufitare Shqipëri-Kosovë.
- 1.3. Rritja e aksesit në shërbimet bazë nëpërmjet lehtësimit të lëvizjes dhe lidhshmërisë të qytetarëve.
- 1.4. Lehtësimi i mobilitetit dhe lidhjes ndërkufitare nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës rrugore.

Neni 3

Ngritja e Komitetit të përbashkët për zbatimin e Marrëveshjes

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, do të krijohet Komiteti i Përbashkët, me qëllim garantimin dhe zbatimin efikas të aktiviteteve të bashkëpunimit në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
2. Brenda 2 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimi, secila palë do të caktojë një Koordinator, për të qenë përgjegjës për menaxhimin e fushave të bashkëpunimit të parashikuara në këtë Marrëveshje.
3. Komiteti i përbashkët do të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve vendore dhe një grup ekspertësh të fushës, të të dy palëve të cilët do të diskutojnë me terma konkret në lidhje me zbatimin konkret të kësaj Marrëveshje.
4. Takimet e Komitetit të përbashkët do të zhvillohen 2 (dy) herë në vit, në Shqipëri dhe në Kosovë, sipas dakordësisë mes palëve.

Neni 4

Bashkëpunimi

Bashkëpunimi i Palëve në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të bazohet në një angazhim vullnetar dhe do të vazhdojë derisa të arrihen qëllimet e tij.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

Dispozitat e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi nuk do të prekin asnjë të drejtë dhe detyrim të Palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe të detyrueshme për to.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe do të jetë i vlefshëm derisa njëra nga Palët ta përfundojë atë duke paraqitur një njoftim me shkrim tek Palët e tjera.


2. Në një rast të tillë, kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të pushojë vlefshmërinë e tij dhe mbetet në fuqi deri në datën e marrjes së njoftimit.

Neni 7 Ndryshimet

1. Palët mund të bien dakord për ndryshime të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, nëpërmjet miratimit të ndërsjellët me shkrim të tyre në çdo kohë.

2. Nënshkruar në ~~PRISHTINE~~ më 20.06.2022, në dy kopje në original, në gjuhën shqipe.

Liburn ALIU



Ministër

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës**

Belinda BALLUKU



Ministër

**Ministria e Infrastrukturës dhe
Energjisë e Republikës së Shqipërisë**